



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.57 prot

Tiranë, më 01.10.2007

**V E N D I M**

**Nr. 57 , Datë 01. 10. 2007**

**Për**

**“ Ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Bukës në Qarkun e Fierit”**

Në zbatim të nenit 24, shkronja d, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 01.10.2007, shqyrtoi Raportin e Grupit të Punës për përfundimin e procedurës së Hetimit Paraprak, të hapur me Vendimin Nr. 455, datë 29.08.2007 të Sekretarit të Përgjithshëm dhe rezultatet e inspektimeve të kryera, prej nga:

**K O N S T A T O I :**

1. Ndërmarrjet nën hetim, “Marlen” sh.p.k , “Basha” sh.p.k, “Apollonia B” shpk, “Fatri Zijaj”, “Vladimir Resuli”, “Lavdiqe Ramaj” (Patos), “Genci Numanaj”(Patos), “Sokol Malaj” (Ballsh), “Ylber Shameti” (Ballsh), “Valter Veizi” (Ballsh), me datë 08.08.2007, kanë nënshkruar një marrëveshje që bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sepse:

1. Fikson çmimet e shitjes së bukës masive në 100 Lekë;
2. Rrit çmimet e llojeve të tjera të bukës me rreth 17%.

2. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi që me datë 16.08.2007 dhe përbën shkelje të rëndë të konkurrencës pasi grupimi i ndërmarrjeve eliminon konkurrencën mes tyre duke fiksuar çmimin e shitjes që bie ndesh me nenin 4/a të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe përbën shkelje të rëndë sipas nenit 74, pika 1, germa a të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, dhe nenin 45 të ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 61 të Kodit të Procedurave Administrative,

### **V E N D O S I:**

1. Ndalimin e Marrëveshjes së lidhur më datë 08.08.2007 ndërmjet ndërrmarjeve prodhuese të bukës në Qarkun e Fierit, më konkretisht midis: “Marlen” Sh.p.k, “Basha” Sh.p.k, “Apollonia B”, “Fatri Zijaj”, “Vladimir Resuli”, “Lavdiqe Ramaj” (Patos), “Genci Numanaj” (Patos), “Sokol Malaj” (Ballsh), “Ylber Shameti” (Ballsh), “Valter Veizi” (Ballsh), si marrëveshje e ndaluar në bazë të nenit 4, pika 1, germa a të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për vazhdimin e hetimit për të përcaktuar pasojat e veprimit antikonkurrues dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.
3. Afati i mbylljes së procedurave dhe marrja e vendimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës do të jetë brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 01.10. 2007

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Lush PËRPALI**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/kryetar**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**